- Info. tek. ms. P.
- Nj. Ad. Pojan
21.12.2020

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

## PËRMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE JONIDA UJKASHI

LN-84236-09-2014 NIPT L42101005V

Rr."Nikolla Jorga", Kulla nr.9,Shk.1,K.5,Ap.29,Tiranë e-mail:j.ujkashi@gmail.com Tel: 04 222 9114

DHKPGJP
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

BASHKIA M... Zyra e Prot... Nr. 6418 Prot... Date 21.12.2020 Nënshkrimi

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT JONIDA UJKASHI

Nr. 2456 Prot

Nr. **503** Dosje Tiranë, më 10.12.2020

**Lënda :** Dërgohet – Shpallje Ankandi III-të Për Shitje Sendi Të Paluajtshëm

**Drejtuar :** Njësia Administrative Pojan

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun

Sektorit të Informimit Qytetar

Bashkëngjitur kësaj shkrese Ju dërgojmë dokumentin me Nr. 2455 Prot, Datë 10.12.2020, për shpalljen e Ankandit të III-të për shitjen e një sendi të paluajtshëm, i përpiluar nga Përmbaruesi Gjyqësor.

Duke qenë në dijeni se pranë çdo Bashkie funksionon Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, apo Sektori i Informimit Qytetar, si edhe masat dhe përgatitjen që bën ky sektor për bërjen publike të informacioneve të ndryshme që vihen në dispozicion të publikut, pa kërkesë,

Ju dërgojmë këtë shpallje për t'a afishuar në ambientet e përcaktuara të Bashkisë, të cilat janë të disponueshme dhe shërbejnë për të njëjtat qëllime informuese.

Referuar neneve 38 dhe 39 të Ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si edhe nenit 568,570 të K.Pr.Civile, kërkojmë nga ana Juaj që të krijohen kushtet e duhura për publikimin dhe mbarëvajtjen e kësaj shpalljeje për një periudhë 30-ditore.

Ju Faleminderit për bashkëpunimin!

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**JONIDA UJKASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË JONIDA K. UJKASHI PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Nr. 150 prot.

Dt. 22.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

PËRMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE JONIDA UJKASHI

LN-84236-09-2014 NIPT L42101005V

Rr."Nikolla Jorga", Kulla nr.9,Shk.1,K.5,Ap.29,Tiranë e-mail:j.ujkashi@gmail.com Tel: 04 222 9114

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT • JONIDA UJKASHI •

Nr. 2455 Prot

Nr. 503 Dosje

Tiranë, më 10.12. 2020

## SHPALLJE

## (PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKANDIN E III-TË)

Unë, Jonida Ujkashi, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat *"Jon 2014"*, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendim nr. 41-2018-1109(115 UE) akti, datë 29.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 503, Datë 30.04.2019 kërkesën e kreditorit ***"Agrokredit sh.a"*** ndaj debitorit Zj. Eni Thanas Dragoj, dorëzanësit Z. Thanas Ali Dragoj dhe dorëzanëses Zj. Majlinda Hasim Dragoj në lidhje me titullin ekzekutiv "Kontratë Huaje me Hipotekë me nr.695 Rep dhe nr.595 Kol, dt.26.01.2016",

Me përmbushjen konform ligjit të të gjithë hapave të parashikuara dhe të kërkuara proceduriale, si edhe me përfundimin e afatit të fundit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm parashikuar në nenin 567,568,577 të Kodit të Procedurës Civile, më datë 16.12.2019 kreva shpalljen për shitjen e sendit të paluajtshëm të sekuestruar debitorëve. Procedura e zhvillimit të ankandit vazhdoi 30-ditë dhe përfundoi me mbarimin e orarit zyrtar të datës 15.01.2020.

Nga procedura e zhvillimit të ankandit si edhe nga procesverbali i datës 15.01.2020 të zhvillimit të tij,

## KONSTATOVA

Se në të gjithë afatin 30-ditor të mbajtjes së afishimit të shitjes së sendit të paluajtshëm, ashtu si edhe në ditën përfundimtare të zhvillimit të tij, nuk u paraqit asnjë ofertë apo ofertues, i cili do të paraqitej si blerës i mundshëm i këtij objekti të përcaktuar me një çmim fillestar në vlerën e 448,000 (katërqind e dyzet e tetë mijë) LEKË.

Me shkresën me nr. 205 Prot, datë 16.01.2020 "SHPALLJE (PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKANDIN E III-të)" bëra shpalljen për shitjen e sendit të paluajtshëm, të publikuar deri më datë 17.02.2020.

Me shkresën me nr.310 Prot, datë 06.02.2020 Vendim "Për pezullimin e Ekzekutimit" vendosa të pezulloja procedurën përmbarimore sipas shkresës me nr. 560/1, dt.03.02.2020 ku kreditori "Agrokredit sh.a" ka kërkuar pezullimin e veprimeve përmbarimore në lidhje me ekzekutimin e këtij Urdhëri Ekzekutimi.

Me shkresën me nr. 46765/6 Prot, datë 04.12.2020 "Kërkesë.." kreditori "Agrokredit" sh.a ka kërkuar vazhdimin e veprimeve përmbarimore për këtë arsye unë vijova me rifillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të Urdhrit të Ekzekutimit Vendim nr. 41-2018-1109(115 UE) akti, datë 29.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Lidhur sa më sipër, referuar neneve 568 dhe 570 dhe 577 të Kodit të Procedurës Civile, si edhe nenit 37(pikat b.c) të Ligjit Nr. 26/2019"Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" bëj përsëri këtë,

## SHPALLJE

**1.** Për shitjen në ankand të sendit të paluajtshëm, si më poshtë treguar:

- Lloji i pronës: "Arë + Truall + Ndërtesë", me sipërfaqe totale 510 $m^2$, Truall 400$m^2$, Ndërtesë 175m2;
- Vendndodhja: Rrethi Korçë, Q/F Zemblak;
- Drejtoria Vendore Korçë, Zona Kadastrale: 3903, Numri i Pasurisë: 176/6, Vol. 12, Faqe 156;

**2.** I cili është në pronësi të shtetasit (Hipotekuesit):

- Z. Thanas Ali Dragoj

**3.** Hipotekat apo të drejtat reale mbi pasurinë tregohen në:
Aktin Noterial "Kontratë Huaje me Hipotekë me nr.695 Rep dhe nr.595 Kol, dt.26.01.2016" inskriptuar nën emër të "Agrokredit sh.a".

Me këtë shpallje njoftoj të gjithë të interesuarit, duke i

**INFORMUAR SE**

a) Çmimi i ri i sendit të paluajtshëm që shitet ka vlerën e **403,200 (katërqind e tre mijë e dyqind) LEKË.**
b) Vendi ku do të zhvillohet ankandi i shitjes së sendit është Zyra e Përmbarimit Gjyqësor Privat "Jon 2014" e cila gjendet në adresën:

RR."NIKOLLA JORGA", KULLA NR.9,SHK.1,K.5,AP.29,TIRANË

c) Ankandi i III-të për shitjen e sendit të paluajtshëm shpallet sot dhe do të qëndrojë i publikuar deri më datë 11.01.2021.

d) Dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrjen në ankand do të pranohen në të gjithë afatin 30-ditor dhe procesi përfundimtar i zhvillimit të tij do të kryhet në datën 11.01.2021 duke u mbyllur në orën 16.00 me mbarimin e orarit zyrtar.

e) Secili ofertues duhet të depozitojë bashkë me kërkesën për pjesëmarrjen në ankand edhe garancinë prej 10% të çmimit fillestar në llogarinë bankare të Përmbaruesit Gjyqësor, **Jonida Ujkashi person fizik pranë "Bankës Kombëtare Tregtare" SHA në Nr. e Llogarisë 431811622 dhe IBAN AL25205113138116 22CLCPCLALLA.**

**KJO SHPALLJE AFISHOHET NË:**

- Bashkinë Korçë;
- Njësinë Administrative Pojan;
- Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- Adresën e sendit të paluajtshëm që shitet: Rrethi Korçë, Q/F Zemblak;
- Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor Privat "Jon 2014".

---

**PËRMBARUESE GJYQËSORE**
**JONIDA UJKASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
JONIDA UJKASHI
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT